

VENDIM
Nr. 208, datë 16.12.2019

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË WENERG SHA, PËR BARRËSIM TË ASETEVE
NË FAVOR TË OTP ALBANIA SHA, PËR EFEKT TË RISTRUKTURIMIT TË
KREDISË PËR FONDET E PËRDORURA, ME QËLLIM FINANCIMIN E
NDËRTIMIT TË HEC-it "DARDHA 1"**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" si dhe në zbatim të nenit 6; nenit 7 dhe nenit 8, të "Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit" të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; pikës 1.3 të "Kushteve të licencës" të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, gjithashtu dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 114/2-1 prot., datë 13.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë Wenerg sh.a., për lënien barrë të aseteve në favor të bankës "OTP Albania" sh.a.,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 749, datë 15.11.2019, shoqëria Wenerg sh.a., ka paraqitur kërkesën për barrësim të aseteve (makineri dhe pajisje) për efekt të ristrukturimit të kredisë për fondet e përdorura me qëllim financimin e ndërtimit të HEC-it "Dardha 1", në favor të bankës "OTP Albania" sh.a.

- Shoqëria Wenerg sh.a. është mbajtëse e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, me nr. 104, seria PV10K, miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 51, datë 5.7.2010, për një periudhë 30-vjeçare dhe modifikuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 11, datë 6.2.2012, për shkak të optimizimit të skemës hidroenergjetike duke përmirësuar projektin.

- Midis METE (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe shoqërisë Compagnie Nationale du Rhone (CN'AIR) me cilësinë e Koncesionarit, është lidhur kontrata e Koncesionit të formës BOT, me nr. 6144 rep. dhe nr. 2021 kol., datë 18.8.2009.

- Aplikimi plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në "Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", si më poshtë:

- neni 7, pika 1, germat: "a", "b", "e", "f", "g", janë plotësuar në mënyrë korrekte.

- neni 7, pika 1, germa "d", (një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare). Pa plotësuar.

- neni 7, pika 1, germa "h", (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve). Plotësuar pjesërisht.

- Nga analizimi i Marrëveshjes së Barrësimit, rezulton se nuk ka në përmbajtje të saj informacion të mjaftueshëm i cili mund të shërbejë për të legjitimuar hapjen e procedurës.

- Shoqëria Wenerg sh.a nuk ka paraqitur më parë në ERE kërkesë për barrësim asetesh. Tashmë jemi përpara një kërkesë për barrësim me qëllim ristrukturimin e kredisë, për financimin e ndërtimit të HEC "Dardha 1".

- Në kushtet kur kredia që po kërkohet të ristrukturohet, është marrë pa miratimin e ERE-s, e nuk disponohet informacion mbi këtë kredi, nuk mund të vlerësohet mbi ristrukturimin e saj.

- Shoqëria Wenerg sh.a ka filluar operimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike në vitin 2012, pra si e tillë rezultoi se HEC-i “Dardha 1”, është ndërtuar shumë kohë më parë.

- Neni 7, pika 1, germa “i”, (Deklaratë me shkrim e personit (subjektit) tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehe gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit). Pa plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa “j”, (Nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt). Pa plotësuar.

- Neni 7, pika 3, (Subjektet koncesionare të licencuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncesionit e pjesët që transferojnë te përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Organit Shtetëror të Autorizuar (MEI) në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve). Pa plotësuar.

Sa më sipër, nuk përmban dokumentacion të mjaftueshëm për të legjitimuar fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së aplikuesit.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Wenerg sh.a., për barrësim të aseteve në favor të “OTP Albania” sh.a, për efekt të ristrukturimit të kredisë, për fondet e përdorura me qëllim financimin e ndërtimit të HEC-it “Dardha 1”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi, në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti